



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 25.01.2025

Nr. 458

Data: 24.01.2025

Nr: 31

Ora: 13:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV BAZUAR NË DENONCIMIN ME NR. 2,  
DATË 14.01.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË ORGANIZATËS  
QENDRA “QENDRESA QYTETARE”**

Sot më datë 24.01.2025, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me:

**KËRKUES:**

Organizata Qendra “Qendresa Qytetare”

**SUBJEKT:**

Drejtori i Shkollës 9 – Vjeçare “Mustafa Greblleshi”, Tiranë  
Drejtori i Shkollës 9 – Vjeçare “Koli Sako”, Divjakë  
Drejtori i Shkollës 9 – Vjeçare “Jashar Dunga”, Kajan  
Drejtori i Shkollës 9 – Vjeçare “Liria”, Ajasem  
Drejtori i Shkollës 9 – Vjeçare “Neim Muçelli”, Pretushë  
Drejtori i Shkollës 9 – Vjeçare “Ahmet Zogu”, Kamëz  
Drejtori i Shkollës 9 – Vjeçare “Shahin Kullolli”, Golik  
Drejtori i Shkollës 9 – Vjeçare “Fatos Lami”, Zall-Mner  
Drejtori i Shkollës 9 – Vjeçare “Klodian Tanushi”, Tiranë  
Drejtori i Shkollës 9 – Vjeçare “Alush Grepcka”, Roskovec  
Drejtori i Shkollës 9 – Vjeçare “Qamil Metalia”, Metaliaj  
Drejtori i Shkollës 9 – Vjeçare “Kostandin Kristoforidhi” Tiranë  
Drejtori i Shkollës 9 – Vjeçare “Spille”, Spille  
Drejtori i Shkollës 9 – Vjeçare “Ismail Jangulli”, Godvi  
Drejtori i Shkollës 9 – Vjeçare “Koli Dimo”, Frashër  
Drejtori i Shkollës së Mesme Të Bashkuar “Arif Zeqiri”, Golaj  
Drejtori i Shkollës së Mesme Të Bashkuar “Mark Jaku”, Gojan i Madh

Nr: 31

Data: 24.01.2025

Ora: 13:00



“Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin me nr. 2, datë 14.01.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Organizatës Qendra “Qendresa Qytetare”

Drejtori i Shkollës së Mesme Pedagogjike “Pandeli Sotiri”, Gjirokastrë  
Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Tiranë  
Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Divjakë  
Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Elbasan  
Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Shkodër  
Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Pogradec  
Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Kamëz  
Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Roskovec  
Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Has  
Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Kavajë  
Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Pukë –  
Fushë Arrëz  
Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Gjirokastrë  
– Libohovë  
Drejtori i Zyrës Arsimore Vendore të Arsimit Parauniversitar Bulqizë  
Drejtori i Zyrës Arsimore Vendore të Arsimit Parauniversitar Patos  
Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë  
Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës  
Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier  
Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë  
Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar

**OBJEKT:** Konstatimi i përdorimit të burimeve publike

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe pika 2, neni 91, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nënpika 1.3, pika c, të nenit 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

### **K O N S T A T O J :**

Organizata Qendra “Qendresa Qytetare”, më datë 13.01.2025, ka paraqitur denoncim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail. Denoncimi është regjistruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 2, në datën 14.01.2025.

Nga shqyrtimi paraprak i të dhënave që përmban denoncimi si dhe dokumentet bashkëlidhur tij pretendohet si vijon:

*“Në faqet zyrtare të institucioneve të arsimit parauniversitare, Zyrave Vendore të Arsimit, si dhe faqja zyrtare e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, janë angazhuar në forma të*

*ndryshme, duke përfshirë pëlqimin, komentimin apo shpërndarjen, me postime që kanë në përmbajtje të tyre thirrje elektorale. Këto angazhime sistematike në këto postime, dhe në postime të tjera që përmbajnë logon e Partisë Socialiste dëshmojnë qartë për njëvënie në përdorim të burimeve publike të një partie politike, në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor”.*

Me vendimin nr. 21, datë 16.01.2025, u vendos fillimi i procedurës administrative, duke i'u kërkuar personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të paraqesin prapësimet në lidhje me çështjen objekt hetimi.

Më datë 21.01.2025, ora 12:00, u zhvillua seanca dëgjimore, ku u ftuan të gjitha palët në proces për t'u shprehur në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Të pranishëm ishin përfaqësuesi i Organizatës Qendra “Qendresa Qytetare” z. Dhimitër Zguro, përfaqësuesit e të gjithë institucioneve subjekt të këtij denoncimi si dhe përfaqësuesit ligjor të subjekteve “Partia Demokratike” dhe “Partia e Lirisë”, si palë të interesuara.

Personat përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në tërësi deklaruan se veprimet nuk kanë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim me interesat e institucionit. Situatat janë krijuar nga gabime njerëzore dhe jo veprime të qëllimshme për favorizim në shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020. Pasi është konstatuar ky gabim njerëzor janë marrë masat për heqjen e postimeve të karakterit elektorale dhe personat përgjegjës siguruan se kjo gjë nuk do të ndodhë në të ardhmen duke qenë shumë të kujdesshëm në menaxhimin e faqeve.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ pas administrimit dhe shqyrtimit të provave, dhe pasi palët u dëgjuan në seancën publike të datës 21.01.2025, u provua se postimet, ripostimet dhe pëlqimet janë bërë në faqet zyrtare të rrjetit social të institucioneve subjekt i këtij denoncimi. Pas verifikimeve të kryera nga ana jonë, u konstatua se postimet, ripostimet dhe pëlqimet, me karakter politik janë fshirë nga rrjeti social i Institucionit.

Për sa më sipër, drejtuesve të institucioneve publike u tërhiqet vëmendje që të tregojnë kujdes të shtuar në publikimin e postimeve apo ripostimeve të ndryshme me përmbajtje politike apo elektorale, duke mos lejuar shpërndarjen dhe ripostimin e veprimtarive politike apo elektorale të Institucioneve të tyre eprore, pasi do të përbënte shkelje të përcaktimeve të nenit 91, pika, 1 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet se *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”.* Po ky nen parashikon se *“burime” quhen asetet e luajshme dhe të paluajshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit”.*

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenin 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar,

## V E N D O S:

### 1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj:

- Drejtorit të Shkollës 9 – Vjeçare “Mustafa Greblleshi”, Tiranë;
- Drejtorit të Shkollës 9 – Vjeçare “Koli Sako”, Divjakë;
- Drejtorit të Shkollës 9 – Vjeçare “Jashar Dunga”, Kajan;
- Drejtorit të Shkollës 9 – Vjeçare “Liria”, Ajasem;
- Drejtorit të Shkollës 9 – Vjeçare “Neim Muçelli”, Pretushë;
- Drejtorit të Shkollës 9 – Vjeçare “Ahmet Zogu”, Kamëz;
- Drejtorit të Shkollës 9 – Vjeçare “Shahin Kullolli”, Golik;
- Drejtorit të Shkollës 9 – Vjeçare “Fatos Lami”, Zall-Mner;
- Drejtorit të Shkollës 9 – Vjeçare “Klodian Tanushi”, Tiranë;
- Drejtorit të Shkollës 9 – Vjeçare “Alush Grepcka”, Roskovec;
- Drejtorit të Shkollës 9 – Vjeçare “Qamil Metalia”, Metaliaj;
- Drejtorit të Shkollës 9 – Vjeçare “Kostandin Kristoforidhi” Tiranë;
- Drejtorit të Shkollës 9 – Vjeçare “Spille”, Spille;
- Drejtorit të Shkollës 9 – Vjeçare “Ismail Jangulli”, Godvi;
- Drejtorit të Shkollës 9 – Vjeçare “Koli Dimo”, Frashër;
- Drejtorit të Shkollës së Mesme Të Bashkuar “Arif Zeqiri”, Golaj;
- Drejtorit të Shkollës së Mesme Të Bashkuar “Mark Jaku”, Gojan i Madh;
- Drejtorit të Shkollës Së Mesme Pedagogjike “Pandeli Sotiri”, Gjirokastrë;
- Drejtorit të Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Tiranë;
- Drejtorit të Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Divjakë;
- Drejtorit të Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Elbasan;
- Drejtorit të Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Shkodër;
- Drejtorit të Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Pogradec;
- Drejtorit të Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Kamëz;
- Drejtorit të Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Roskovec;
- Drejtorit të Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Has;
- Drejtorit të Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Kavajë;
- Drejtorit të Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Pukë – Fushë Arrëz;
- Drejtorit të Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Gjirokastrë – Libohovë;

- Drejtorit të Zyrës Arsimore Vendore të Arsimit Parauniversitar Bulqizë;
  - Drejtorit të Zyrës Arsimore Vendore të Arsimit Parauniversitar Patos;
  - Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë;
  - Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës;
  - Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier;
  - Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë;
  - Drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
  3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
  4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Nr: 31      Data: 24.01.2025  
Ora: 13:00



“Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin me nr. 2, datë 14.01.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Organizatës Qendra “Qendresa Qytetare”